

VENDIM
Nr. 550, datë 13.6.2013

**PËR KTHIMIN NË FOND BANESE TË ISH-KONVIKTIT TË SHKOLLËS SË REZERVAVE, NË
RRUGËN “KRISTO FLOQI”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11, 14 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ish-Konvikti i Shkollës së Rezervave, në rrugën “Kristo Floqi”, Tiranë, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimin në favor të banorëve të pastrehë, të cilët banojnë në këto objekte, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet ky ent të bëjë kalimin në pronësi të këtyre objekteve për banorët e pastrehë, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave, Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

BASHKIA E TIRANËS

DREJTORIA NR. 3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

**LISTA E FAMILJEVE QË BANOJNË NË GODINAT E ISH-KONVIKTIT TË SHKOLLËS SË
REZERVAVE NË RRUGËN “KRISTO FLOQI” DHE NUK KANË PËRFUNDUAR PRIVATIZIMIN E
BANESAVE**

1	Viktor Mirash Prendi	
2	Asqeri Ismail Lumani	
3	Bardha Pjetër Pjetra	
4	Pjetër Lesh Lasku	
5	Suzana Sefer Tahiri	
6	Shtjefën Lekë Pjetri	
7	Lirim Isa Zene	
8	Novruz Ilmi Dulemati	